



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **01.06.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Medi Health L.L.C.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” - Lot 8**, me nr. të Prok: **206-23-11488-1-1-1**, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Medi Health L.L.C., e dt. 01.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” - Lot 8** me nr. të Prok: **206-23-11488-1-1-1** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 28.05.2024;
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 28.05.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit për Lot 8;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Medi Health L.L.C., me date 01.06.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” – Lot 8** me nr. të Prok: **206-23-11488-1-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 21.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Ligji për prokurim publik, nr 04/L-042 i amandamentuar me ligjet tjera  
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti  
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi  
Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit  
Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 51 Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes  
Neni 52 Njoftimi i kriteve për dhënien e kontratës  
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave  
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve  
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë  
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve  
Neni 130 Ndikimi i Paligjshëm  
Neni 131 Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues  
**Rregullorja për prokurim publik nr. 001/2022**  
Neni 38 Sqarimi i Tenderëve  
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve  
Neni 97 Shkeljet e rënda

#### Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te nderuar,

Operatori Ekonomik “Medi Health” LLC, fillimisht me datën 02.04.2024, sipas letres standarde është kualifikuar si oferte e përgjegjeshme lidhur me lotin 8, “*Furnizimi me pajisje për zhvillim të procesit teaferezes për Klinikën e Nefrologjisë*”, përkatësisht kompani sonë me datën 28.03.2024, na janë kerkuar që të dorëzohen kërkesat e pershtatshmerise si parakusht i lidhjes se kontratës, e konfirmuar edhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.

- Prove njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 02.04.2024.

Pas kërkeses për ri shqyrtim të datës 04.04.2024, të OE tani të rekomanduar “Agro Med” shpk, ju si AK – MSH, aprovoni të njëjten kërkesë si pjesërisht të bazuar dhe lenden e këtheni në ti vlerëim, ku tani eliminoni ofertën tone dhe rekomandoni për dhënie të kontratës të cilën me të njëjtin vendim e keni eliminuar, rrjedhimisht në kuptim të nenit 108/A të LPP-se, paraqesim këtë:

#### KERKESE PËR RI-SHQYRTIM

**Pretehimet ankimore:**

1. Oferta e Operatorit Ekonomik ankues “Medi Health” LLC, lidhur me procedurën e prokurimit të sipër përshkruar dhe lotin 8, fillimisht është kualifikuar si e përgjegjeshme dhe si e tillë është rekomanduar për dhënie të kontratës, nga komisioni profesional i autorizuar nga AK – MSH e konfirmuar edhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, rrjedhimisht arsyetimi i eliminimit të ofertës sonë pas procesit të Ri vlerësimit paraqet shkelje nga neni 52.3, 56.3 dhe 59 i LPP-se, rrjedhimisht për Ri shqyrtim të ofertave ju si AK -MSH, keni krijuar komision të ri të ofertave në kundërshtim me LPP. Ligjerisht Rishqyrtimi realizohet nga komisioni i njëjtë.
2. Pas rekomandimit për dhënie të kontratës juve si AK – MSH, pranoni kërkesë për Rishqyrtim nga OE “ArgoMed” shpk dhe atë me datën 07.04.2024. Kundrejt kesaje kërkesë Autoriteti i juaj kontraktues – Minsistria e Shendetesise, përkatësisht zyrtari

përgjegjës i prokurimit nxjerr vendim dhe atë pas rreth 23 diteve, aprovohet kërkesa si pjesërisht e bazuar, lënda kthehet në Ri vlerësim por përmes të njëjtit vendim dhe arsyetimit, përkatësisht në faqen 8, gjegjësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit eliminon ofertën e të njëjtit dhe atë me arsyetimin se paisjes i mungojnë kërkesat e specifikacioneve teknike të detyrueshme nga pikat e vetë përshkruara:

2. Pajisje për ndarje të qelizave të gjakut - Pajisja Aferezë (Operatori Ekonomik ankues ka ofertë me pajisjen BAXTER PRISMA FLEX dhe si pajisje i ofron të gjitha specifikat e kërkuara nga DT mirpo mungojnë pikat e poshtë shënuara.

7.3 Suitable maintenance free battery UPS for minimum one-hour backup shall be supplied with the system.

7.4 List of equipment available to provide calibration and routine preventive maintenance support, according to the manufacturer's documentation in the service/technical manual.

Bazuar në nenin 108/A, par 6 të LPP-se afati për vendosje dhe nxjerrje të vendimit është 3 ditë pune dhe në raste komplekse mund të vazhdohet afati edhe për 3 ditë tjera por duhet të nxjerrët vendim i veçant për zgjatje të afatit.

*"Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuar mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".*

Mos t'ijajtimi i rregullave për trajtim të kërkesës për ri shqyrtim pran AK, sipas pikës e) të nenit 97, të rregullores nr. 001/2022, konsiderohet si shkelje e rëndë.

3. Përkundër faktit se në vendim ndaj kërkesës për ri shqyrtim të nxjerre ditën e 23, pas kërkesës për Ri shqyrtim oferta e OE "ArgoMed" eliminohet si e pa përgjegjeshme, tani sipas vendimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe pas Ri vlerësimit, të publikuar me datën 27.05.2024, e njëjta oferta doli të jetë e përgjegjeshme përkundër mangesive të konstatuara !

Në si Ooperator Ekonomik ankues, jemi të bindur se ndaj ofertës është kërkuar sqarim shtesë, është pranuar dokumentacion shtesë apo deklarat shtesë, me të cilat është ndryshuar oferta dhe ka pesuar ndryshim në aspekt material, ndryshime këto të ndaluar ligjërisht përkatësisht me nenin 59 të LPP-se dhe dispozita tjera ligjore.

4. Në vazhdim mund të gjeni përgjigjet në arsyetimet e juaja për eliminim të ofertes tone:

### ARSYETIM

Oferta Juaj për Lot 8 është e papërgjegjshme për këto arsye:

Pajisja e ofruar nga ana juaj e modelit Braun OMNI® ECCO2R, sipas dokumenteve të ofertës nuk plotëson specifikat teknike si më poshtë:

- a. With this device, the procedure for reducing the load of endogenous inflammatory toxins in the circulation (eg in septic conditions) is possible - Kjo specifikë teknike nuk gjendet në katalogët e dosjes së tenderit të ofertës;
- b. The possibility of treating septic conditions - Kjo specifikë teknike nuk gjendet në katalogët e dosjes së tenderit të ofertës;

Nuk e keni dëshmuar me dokumente edhe për set-et:

5.2 Thirty (30) disposable plasma exchange therapy kits and sets, thirty (30) for sepsis,

Ndërsa për set-et e më poshtë të kërkuara:

- (10) For each form of CRRT, must be provided and delivered with the equipment.

Ju keni ofertuar Set-in: OMNI® ECCO2R i cili në bazë të dokumentacionit mund të përdoret për largimin e CO2 dhe në të gjitha modelt e CRRT por nuk ka informata që mund të përdoret për (Therapeutic Plasma Exchange) TPE dhe treating septic conditions. Pra ju keni ofruar vetëm dokumentin për setin OMNI® ECCO2R, ndërsa mungojnë dokumentet për set-et e tjera.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-012 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
Berat Marmullaku  
(Enari dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi)

*<sup>1</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qorë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shiko letra njoftuese sipas nevojës).*

1

Si fillim, për informimin tuaj, pajisja nuk quhet Braun OMNI ECCO2R por quhet vetëm Braun OMNI, por ju nuk i referoheni katalogut të pajisjes ku janë të specifikuar dhe të nenvizuara të gjitha funksionet që kryen aparati Braun OMNI (përfshirë edhe TPE) ku deshmohet që i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-se, por i referoheni gabimisht katalogut të Set-it OMNI ECCO2R që nuk është kërkesë e DT, por të cilin ne e kemi dorëzuar me ofertën tonë për të dëshmuar që aparati Braun OMNI përveç që kryen të gjithë funksionet e kërkuara në FDT, trajton edhe largimin e CO2 nga gjaku, që është procedure shumë e rëndësishme dhe një beneficion për pacientet që kanë nevojë për këtë procedure.

Prentendimi i AK-MSH se oferta jone nuk plotëson specifikat teknike në pikën a dhe b nuk qendron, pasi ne kemi ofruar deshmë në ofertën tonë që aparati Braun OMNI i plotëson këto kritere të cilat një profesionist i kësaj fushe i kupton se bëhet fjalë për largimin e komponenteve patogjene nga plazma e gjakut (term ky që përdoret për të gjithë shkaktaret e gjendjes septike), me një fjalë e pastron gjakun nga komponentet toksik.

Per te ju perkujtuar nga te dhenat e meposhtme shihet qarte se aparati Bbraun OMNI perpos qe trajton sepsen, kryen edhe disa funksione tjera te rendesishme te cilat mund te shihni ne grafikonin e meposhtem.

Prove: Dëshmit nga katalogu i prodhuesit te paisjes “B.Braun”, sa i përket pikave te eliminimit a dhe b.

Pika 1.2  
1.3  
1.4

## 2.9 Clinical Benefits

### 2.9.1 Clinical Benefits of Continuous Blood Purification Treatment

Continuous blood purification provides a life-saving treatment and includes the following clinical benefits:

- Removal of excess fluid
- Removal of uremic retention solutes and toxic molecules (small- and middle-molecular weight)
- Electrolyte removal and control
- Acid-base adjustment

### 2.9.2 Clinical Benefits of Therapeutic Plasma Exchange

Therapeutic plasma exchange provides the following clinical benefits:

- Removal of pathogenic plasma components
- Replacement of pathologically modified plasma by plasma substitution fluid

# BICARBONATE BASED SOLUTIONS

## PERSONALIZING THERAPIES

The patients conditions can change often and require adoptions of renal replacement therapy. Fluid management is one of the major and most frequent therapeutic challenge. Patients afflicted with acid-base disturbances require an adequate buffering which is an important component of successful treatment. To accomplish these objectives a careful selection of the most suitable solutions for each patient is necessary.



Aparati mund te perdoret edhe per trajtimin e rasteve te paraqitura ne keto grafion.

**CLINICAL CHARACTERISTICS**

- Correction of metabolic acidosis
- Low cardiovascular complications
- Physiological buffer solution

REFERENCES  
 \*Kellum JA, Lame C, Ross S, Francis J, et al. Bicarbonate-buffered solutions in continuous renal replacement therapy. *Kidney Int* 2005;68 (Suppl 77): S1-S5.  
 \*Kellum JA, Mehta RL, MacIntyre S, et al. Effects of bicarbonate-buffered dialysate on acid-base balance in ESRD patients. *Am J Kidney Dis* 2006;48 (5): 551-558.  
 \*Chik L, DeKoven A, Salsky J, Hughes M, Pines C. The Impact of Bicarbonate-buffered High Volume Hemofiltration on Acid-Base Balance. *Intensive Care Med* 2003; 28: 1193-1194.

Sa i perket arsyetimit te eliminimit te AK-MSH se nuk kemi deshmuar me dokumente per set-et, ne kerkesen e FDT ne kete pike nuk jane kerkuar dokumente per Set-et por eshte kerkuar qe se bashku me aparatoren te dorezohen edhe Setet per Plazma Exchange(30), Sepse(30) dhe te gjitha format e CRRT(nga 10), gje te cilen po e perserisim edhe nje here qe e kemi deshmuar se do ti dorezojme sipas kerkeses me Deklaraten e bashkengjitur ne oferten tone te cilen mund ta gjeni ne faqen 24 te dokumentit te emeruar "OMNI\_Specificimi i nenvizuar", e qe pas kerkeses tuaj e kemi percjellur perseri permes e-mail e per te cilin ju si AK insistoni disa here qe ky dokument nuk eshte ne oferte, gje qe na ben te mendojme qe kjo nuk ndodh rastesisht.

Arsyetimi i eleminimit te kompanis sonë me pershkrimin e larte prezantuar se oferta jone ka mangesi teknike, si dhe pretendimet qe nuk kemi ofruar dokumente qe nuk kane qene pjese e kerkesave te FDT shperfaqin tendencen dhe shperfaqin abuzimin me paran publike dhe me parime e dispozita ligjore.

I gjith arsyetimi i eleminimit apo tentativa për eliminim te ofertës, konsumon shkelje ligjore nga neni 52.3 dhe 56.3 te LPP-se ku shprehimisht percaktohet:

*"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

5. Ne anen tjetër, ju si Autoritet Kontraktues – Ministria e Shendetesise, keni rekomanduar për dhënie te kontratës oferte te pa pergjegjeshme ne aspektin financiar dhe aspektin teknik te konfirmuar me vendimin tuaj te datës 27.05.2024, ku keni cekuar mangesite e ofertes se OE "Argo Med" sa i perket pikes 7.3 dhe 7.4 te FDT, por quditerisht tani te njejtin e rekomadoni për dhëni te kontratës duke i tejkaluar keto mangesi ne oferten e tyre.

2. Pajisje për ndarje të qelzave të gjakut - Pajisja Aferezë (Operatori Ekonomik ankues ka ofertu me pajisjen BAXTER PRISMA FLEX dhe si pajisje i ofron të gjitha specifikat e kërkuara nga DT mirpo mungojnë pikat e poshtë shënuara.  
7.3 Suitable maintenance free battery UPS for minimum one-hour backup shall be supplied with the system.  
7.4 List of equipment available to provide calibration and routine preventive maintenance support, according to the manufacturer's documentation in the service/technical manual.

Prandaj ne si Operator Ekonomik ankues, jemi te bindur se ndaj ofertës se OE Argo Med ose është kerkuar sqarim shtese, dhe është pranuar dokumentacion shtese apo deklarar shtese, me te cilat është ndryshuar oferta dhe ka pesuar ndryshim ne aspekt material, ose oferta e ketij Operatori Ekonomik eshte pranuar me mangesite e cekura nga vet ju, te dyja keto perbejne shkelje te renda te LPP-se perkatësisht me nenin 59 te LPP-se dhe dispozita tjera ligjore.

Andaj ne si operator ekonomik ankues permes kesaj kerkesë për Ri shqyrtim kërkojmë nga ju si Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shendetesise, gjegjesisht nga zyrtar pergjegjës te prokurimit, qe ne kuptim te dispozitave ligjore, ne kuptim te gjendjes faktike dhe provave te prezantuara si me sipër ta nxjerrëni kete:

## V E N D I M

- I. Te aprovohet ne tërësi si e bazuar kerkesa për ri shqyrtim e OE "Medi Health".
- II. Te anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 27.05.2024, si i kunderligjeshem dhe lënda te kthehet ne Rivleresim;
- IV. Te kualifikohet si e pergjegjeshme oferta e OE ankues: "Medi Health" LLC – Prishtine, si e pergjegjeshme me cmimin me te ulet.

### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Akoma te pa llogaritura.

### Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore

Fillimisht ju njoftojme se Kerkesen tuaj per rishqyrtim e kemi trajtuar me seriozitetin me te lartë dhe me qellimin me te mire qe nese eshte e mundur teknikisht kjo kerkesa te u aprovohej meqense jeni ofertuesi me çmim me te lirë ne këtë Lot dhe vonesa per kthimin e pergjigjes per shqyrtimin e kesaj ankese eshte pikerisht per kete fakt.

Heren e pare u kemi shpallur fitues ne baze te vleresimit fillestar te komisionit vleresues, por per shkak te ankeses se OE tjeter dhe pretendimeve ankimore per aspektin teknik te ofertes tuaj, te cilat jane perkratur nga profesionistet – bioinxhinieret, me daten 30.04.2024 lenda eshte kthyer ne rivlerësim.

Pas ri-vleresimit dhe shpalljes fitues te OE ArgoMed shpk, me daten 01.06.2024 ju jeni ankuar dhe ne si AK-MSh kiemi konsultuar SHSKUK-ne si Njesi e Kerkeses, Klinikën e Nefrologjise, si dhe me qllim te sqarimit te aspekteve teknike te kontestuara ne oferten tuaj, me daten 11.06.2024 i kemi shkruar prodhuesit tuaj BBraun ne emailin e marre nga katalogu '[dialysis@bbraun.com](mailto:dialysis@bbraun.com)' por nuk kemi marre pergjigje.

Pastaj me daten 20.06.2024 i kemi shkruar prap prodhuesit tuaj BBraun ne emailin e marre nga autorizimi '[gordon.voelksen@bbraun.com](mailto:gordon.voelksen@bbraun.com)' duke e vene "cc" edhe '[dialysis@bbraun.com](mailto:dialysis@bbraun.com)'

Ne te njëjtën dite kemi pranuar sqarimin me shkrim nga z. **Gordon Völksen** rreth pikave te kontestuara te specifikave (shih emailin si deshmiv me poshtë).

Sqarimet e dhëna nga z. Gordon janë trajtuar nga SHSKUK dhe pergjigja e tyre eshte se pajisja e juaj nuk eshte e pranueshme, siç shihet nga pikat 1 dhe 2 Pajisja nuk i plotëson kërkesat tona nga Dosja e Tenderit dmth kemi pas të drejtë kur kemi thënë që pajisja nuk e bën SEPSEN.

Pastaj kjo pajisje sipas spjegimit të z. Gordon SEPSEN e bënë nëpërmjet seteve të veçanta OMNiset® Plus, e për këto sete OE nuk ka ofruar asnjë broshur dhe ne nuk jemi te sigurt se qka ofron.

Sa i përket pikës 3, z. Gordon e ka konfirmuar se BBraun nuk prodhon Filtera dhe Absorbera për pajisjen e vet, atëherë kush mundet neve te na siguroj që pajisja do te funksionoj siç duhet.

Pika 4 rreth autenticitetit te katalogëve, konfirmimi i z. Gordon është ne rregull.

Shih pyetjen e AK-MSh drejtuar z. Gordon Völkxen dhe sqarimin e dhënë prej tije:

Reply Reply All Forward



Thu 6/20/2024 10:05 AM

Berat Marmullaku

Request for clarification (Ministry of Health/Kosovo)

To 'gordon.voelksen@bbraun.com'

Cc 'dalysis@bbraun.com'

Retention Policy DelFiveYOldEm (5 years)

Expires 6/19/2029

This is the most recent version, but you made changes to another copy. Click here to see the other versions.



Dear,

I am writing on behalf of Ministry of Health, Republic of Kosovo.

In a procurement activity, an economic operator has offered the device EXTRACORPOREAL BLOOD AND PLASMA TREATMENTS SYSTEM type OMNI<sup>®</sup> and EXTRACORPOREAL CO2 REMOVAL IN COMBINATION WITH OMNI<sup>®</sup> type OMNI<sup>®</sup> ECCO2R, manufactured by B/Braun, see the attached catalogs.

In the tender file, one of the requests was:

1.4 With this device, the procedure for reducing a load of endogenous inflammatory toxins in the circulation (eg in septic conditions) is possible.

Please clarify the following:

1. Does this device perform the required function no. 1.4 does it treats the patients with septic conditions?
  2. Does the device treat sepsis?
  3. Does B.BRAUN produce filters for the treatment of septic conditions?
  4. Confirm if the catalogs are authentic for the devices in question.
- As well as any additional clarification you deem necessary.

If possible, replay to us in writing as soon as possible.

Best Regards,

Berat Marmullaku  
Head of Procurement Division  
Division of Procurement, MoH  
Tel:office: +381(0) 200 24-098



Shih sqarimin e dhënë nga z. Gordon Völksen:

Reply Reply All Forward



Thu 6/20/2024 11:23 PM

Gordon Völksen <gordon.voelksen@bbraun.com>

WG: Request for clarification (Ministry of Health/Kosovo)


To Berat Marmullaku

Cc Jana Hoehle

Retention Policy DelFiveYOIdEm (5 years)

Expires 6/19/2029

You forwarded this message on 6/21/2024 8:04 AM.



Action Items

+ Get more

Dear Mr. Marmullaku,

Thank you very much for your e-mail and your kind call earlier today. Please excuse the shortage of our conversation as I had been in between two appointments.

Regarding your request for information, we have compiled following pieces of information for you:

1. Does this device perform the required function no. 1.4 does it treats the patients with septic conditions?  
- Yes, OMNI<sup>®</sup> is able to perform therapies that reduce the load of endogenous inflammatory toxins in the circulation (e.g. in septic conditions). These therapies are possible using OMNiset<sup>®</sup> Plus, compatible with most Adsorbers available in the market, such as CytoSorb and Jafron, in conjunction with CRRT.
2. Does the device treat sepsis?  
- OMNI<sup>®</sup> itself does not treat sepsis, as OMNI<sup>®</sup> is a medical platform for extracorporeal blood purification treatments. Sepsis treatment with OMNI<sup>®</sup> is possible using OMNiset<sup>®</sup> Plus, compatible with most Adsorbers available in the market, such as CytoSorb and Jafron, in conjunction with CRRT.
3. Does B.BRAUN produce filters for the treatment of septic conditions?  
- No, B. Braun does not produce filters or adsorbers for the treatment of septic conditions.
4. Confirm if the catalogs are authentic for the devices in question.  
- Catalog, brochure, data sheet and IFU provided as attachments to the previous email are authentic for B. Braun OMNI<sup>®</sup> device.

Please do contact me in case of further and/or additional question.

Trust to having been of assistance, I remain with best regards,

Gordon Völksen  
Area Sales Manager | Eastern Europe & The Balkans  
+49 151 14947336  
[gordon.voelksen@bbraun.com](mailto:gordon.voelksen@bbraun.com)

B. Braun Avitum AG - part of the B. Braun Group  
Global Marketing & Sales  
Schwarzenberger Weg 73-79  
34212 Melsungen  
Germany

[www.bbraun.com](http://www.bbraun.com)  
[www.linkedin.com/company/bbraun-group](https://www.linkedin.com/company/bbraun-group)

As a true partner  
we develop smart solutions

Siç e dini kjo pajisje per Plasmarefereze eshte e para qe pritet te blehet ne Republiken e Kosoves dhe eshte sherbim I ri qe pritet te shtohet ne shendetesine tone, konkretisht ne QKUK.

Kjo pajisje do u sherbej disa Klinikave dhe eshte me shume e rendesishme per MSh-ne se kur do arrije te furnizohet dhe te filloj si nsherbim i ri ne shendetesine tone.

Siç jemi te njoftuar nga Klinika e Nefrologjise pacientet me nevoje per kete sherbim jane duke u derguar per trajtim jasht vendit, per mungese te kesaj aparature, rendesia e se ciles eshte shume e madhe se sa vlera rele per blerje qe ajo ka, andaj kerkojme edhe nga ana juaj si OE qe ta keni parasysh kete fakt dhe demtimin e pacienteve nga vonesa e kesaj procedure.

Duke marre parasysh rendesine e saj dhe fokusin qe ka ky sherbim i ri, ne nuk guxojme te blejme nje pajisje e cila kontestohet nga profesionistet dhe nuk ka siguri funksionimi i saj per sherbimet e kerkuara, pasi qe ne baze te dokumentave te ofertes tuaj dhe sqarimeve te dhena rreth ofertes tuaj, shihet se kemi te bejme me kombinimin ne mes dy pajisjeve OMNI® dhe OMNIset® Plus, dhe me filtera te prodhuesve tjere (jo te BBraun), d.m.th. nuk eshte pajisje unike.

Duke marre parasysh konfirmimin e z. Gordon Völksen nga BBraun ne piken 3 se BBraun nuk prodhon filtra ose adsorberë për trajtimin e kushteve septike, atehere oferta juaj per filtera duhet te ishte e ndare me dokumentacion dhe te deshmohej te gjitha kerkesat e kerkuara ne NJK dhe DT, si: Emri i prodhuesit te filterave, Autorizimi, CE certifikata, katalogu, etj, gje qe ju nuk e keni ofruar, por i keni ofruar filterat sikur te ishin te BBraun, e qe ne fakt nuk prodhohen nga BBraun, siç e ka konfirmuar z. Gordon Völksen me shkrim.

### **3. Does B.BRAUN produce filters for the treatment of septic conditions?**

- No, B. Braun does not produce filters or adsorbers for the treatment of septic conditions.

Ne baze te sqarimeve te lartcekura, pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara dhe mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 28.05.2024.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit